

Titulli i Dokumentit:	Raporti i Pajtueshmërisë Rregullatore për vitin 2022	
Nr. i Dokumentit:	CAL00-TAP-RCO-X-TRF-0006	Rish. 0
Klasifikimi:	PUBLIK	

Trans Adriatic Pipeline AG

Raporti i Pajtueshmërisë Rregullatore për vitin 2022

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje.....	3
1.1 Objekti.....	3
1.2 Qëllimi.....	3
1.3 Shkurtesa dhe përkufizime	3
2. Referenca	5
3. Zbatimi dhe monitorimi i PPRr	6
3.1 PPRr-ja e zbatueshme	6
3.2 Frekuentimi i mbledhjeve dhe aksesit në të dhëna	6
3.3 Dhënia e rekomandimeve dhe e asistencës/këshillave.....	6
3.3.1 Mosbërja publike/moskomunikimi i Informacionit me Ndjeshmëri Tregtare dhe i këshillave rregullatore të OPST-së	7
3.4 Shkeljet e mundshme	7
3.5 Raportet për Autoritetet dhe Bordin	7
3.6 Pavarësia operationale.....	7
3.7 Pavarësia organizative	8
3.7.1 Kërkesat për pavarësinë	8
3.7.2 Emërimi, rinovimi dhe përfundimi i mandatit të Bordit të TAP-it, Drejtorit Menaxhues dhe anëtarëve të tjerë të Ekipit të Lidërshipt	8
3.8 Trajnimet dhe komunikimi	8
4. Dokumentacioni	11
5. Lista e Shtojcave	12

Titulli i Dokumentit:	Raporti i Pajtuëshmërisë Rregullatore për vitin 2022	
Nr. i Dokumentit:	CAL00-TAP-RCO-X-TRF-0006	Rish. 0
Klasifikimi:	PUBLIK	

1. Hyrje

PPRr-ja e TAP-it është hartuar nga TAP-i për të ofruar një kuadër të brendshëm detyrues, për të siguruar që në cilësinë e OPST-së së certifikuar, TAP-i dhe punonjësit e tij, Bordi, përfaqësuesit e Aksionarëve, të komanduarit dhe konsulentët e tij të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në kuadrin rregullator të TAP-it, konkretisht DG, seksioni 4.5.1 dhe

4.5.2 i Opinionit të Përbashkët Përfundimtar, Vendimi i Certifikimit dhe dokumentacioni i qeverisjes së korporatës i TAP-it, duke përfshirë Statutin dhe Rregulloret e tij Organizative. PPRr-ja synon që (a) Operacionet e TAP-it të kryhen në mënyrë të pavarur dhe (b) që të pengohet ndikimi nga aktivitetet e furnizimit dhe prodhimit, Sjellja Diskriminuese kundrejt palëve të treta dhe bërja publike e INT-së.

Në përputhje me PPRr-në, OPRr-ja harton/përgatit një raport vjetor, ku përcakton masat e marra për të zbatuar PPRr-në dhe Shtojcën 1 të tij, duke përfshirë shkeljet e ndodhura dhe masat disiplinore të marra (nëse ka), dhe u dorëzon Autoriteteve versionet konfidenciale dhe jokonfidenciale deri më 31 mars të çdo viti. Versioni jokonfidencial i raportit vjetor do të bëhet publik nëse dhe sikurse kërkohet herë pas herë nga legjislacioni përkatës i zbatueshëm dhe rregulloret në fuqi. Gjithashtu, raporti vjetor do t'i dërgohet Bordit për qëllime informimi.

Ky Raport Vjetor i Pajtuëshmërisë Rregullatore mbulon aktivitetet e kryera në vitin 2022.

1.1 Objekti

Ky Raport Vjetor i Pajtuëshmërisë Rregullatore përqendrohet te pajtuëshmëria rregullatore e energjisë dhe është hartuar për të siguruar pajtuëshmërinë e TAP-it me DG-në dhe PPRr-në. Po ashtu, ai synon të përforcojë angazhimin e TAP-it për aderimin dhe zbatimin e kërkesave të tij të certifikimit OPST, dhe ruajtjen e marrëdhënies që qëndrueshme të TAP-it me Autoritetet dhe palët e tjera të interesit. Pajtuëshmëria me certifikimin OPST dhe detyrimet e lidhura gjatë aktiviteve të përditshme të transmetimit si një OPST trajtohen si elemente të rëndësishme të strategjisë së biznesit të TAP-it.

1.2 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti pajtuëshmërie është të:

- përmbushë detyrimin e OPRr-së për të hartuar një raport vjetor, duke përcaktuar masat e marra për të zbatuar PPRr-në, sikurse është rënë dakord me Autoritetet, në përputhje me Nenin 21(3) (b) të DG-së dhe dispozitat përkatëse të vendimeve kombëtare të Autoriteteve që miratojnë PPRr-në e ndryshuar dhe OPRr-në e re;
- përmbledhë detyrat dhe aktivitetet e OPRr-së në periudhën aktuale të raportimit dhe
- për t'u demonstruar Autoriteteve, Bordit dhe EL-së se përgjegjësitë e pajtuëshmërisë rregullatore të TAP-it menaxhohen në mënyrën duhur.

1.3 Shkurtesa dhe përkufizime

Ju lutemi, kini parasysh se termat e përcaktuar te tabela më poshtë dhe në këtë raport kanë kuptimin që u është dhënë te PPRr-ja.

DOT	Data e Operacioneve Tregtare (pra 15/11/2020)
INT	Informacion me Ndjeshmëri Tregtare
MTG	Marrëveshja për Transportin e Gazit



DG	Direktiva e Gazit
OPST	Operatori i Pavarur i Sistemit të Transmetimit
EL	Ekipi i Lidershipit
OM	Operimi dhe Mirëmbajtja
OPRr	Oficer i Pajtueshmërisë Rregullatore
PPRr	Programi i Përputhshmërisë Rregullatore



2. Referenca

LT-RAE-TAP-00019	Miratimi i Programit të rishikuar të Pajtueshmërisë të shoqërisë TAP AG për fazën e operimit të tubacionit të TAP-it
LT-ERE-TAP-00016	Vendimi i Bordit të ERE-s Nr. 149, datë 10.09.2020
LT-AEEG-TAP-00015	Miratimi i Programit të Pajtueshmërisë i përgatitur nga TAP AG në përputhje me vendimin përfundimtar për ta certifikuar TAP AG si një operator të pavarur të sistemit të transmetimit të gazit natyror.

3. Zbatimi dhe monitorimi i PPRr

3.1 PPRr-ja e zbatueshme

PPRr-ja u miratua fillimisht nga Autoritetet në vitin 2014. Pati edhe dy seri të mëvonshme ndryshimesh në PPRr-në e miratuar nga Autoritetet: në vitin 2016 dhe 2020. Seti më i fundit i ndryshimeve të miratuara në vitin 2020 nga Autoritetet¹ pasqyrojnë hyrjen e TAP-it në operacione tregtare. Nëpërmjet këtij programi, TAP-i i informon punonjësit e tij (duke përfshirë drejtuesit e nivelit të lartë), anëtarët e Bordit, Konsulentët, përfaqësuesit e Aksionarëve, të komanduarit, *ndër të tjera*, lidhur me kuadrin rregullator të TAP-it (duke përfshirë objektin e vendimit të tij të përjashtimit dhe kërkesat e certifikimit të OPST-së), identifikimin dhe parandalimin e bërjes publike të INT-së, çfarë janë kërkesat e pavarësisë dhe se si ato zbatohen nga TAP-i.

Kjo PPRr e përditësuar u zbatua dhe u publikua në faqen e internetit të TAP-it në DOT.²

3.2 Frekuentimi i mbledhjeve dhe aksesit në të dhëna

Në përputhje me DG-ë dhe PPRr-në, OPRr-ja mund të ndjekë të gjitha mbledhjet e organeve drejtuese ose administrative të TAP-it, duke përfshirë mbledhjet e EL-së, Bordit, Komiteteve Këshillimore të Bordit dhe Aksionarëve. Për sa u përket çështjeve të përcaktuara në Nenin 21(8) të DG-së, OPRr-ja është e detyruar të ndjekë të gjitha mbledhjet. OPRr-ja informohet për agjendat dhe të gjitha materialet e prezantuara ose të bëra publike në këto mbledhje. Gjatë periudhës së raportimit, OPRr-ja ndoqi mbledhjet e Bordit të TAP-it, EL-së dhe Komiteteve Këshillimore të Bordit.

OPRr-ja ua ofroi gjashtë përditësimet e pajtueshmërisë (duke përfshirë pajtueshmërinë rregullatore të OPST-së, pajtueshmërinë e përgjithshme dhe mbrojtjen e të dhënave) një Komiteti të dedikuar Këshillimor të Bordit dhe drejtpërdrejt Kryetarit të Bordit.

OPRr-ja u përfshi në përgatitjen e dokumenteve për Bordin, EL-në, Komitetet Këshillimore të Bordit, duke përfshirë agjenda, procesverbale mbledhjesh, prezantime dhe materiale të parashtruara nga drejtuesit e TAP-it dhe departamente të ndryshme. OPRr-ja ka ndjekur mbledhjet javore me ekipet ligjore, tregtare, të prokurimit dhe Sekretariatit të Shoqërisë, mbledhjet mujore me Përfaqësuesit për Vendin dhe mbledhjet tremujore me Menaxherët OM. OPRr-ja ka pasur akses në të dhënat dhe informacionet e nevojshme përkatëse për përbushjen e detyrave të saj, duke përfshirë skedarë, dokumente dhe të gjitha të dhënat elektronike përkatëse.

Diskutimet lidhur me INT-në mund të zhvillohen vetëm nëse OPRr-ja ndjek mbledhjen përkatëse të Bordit, EL-së, Komiteteve Këshillimore të Bordit, ose në ka dhënë miratimin paraprak për këto diskutime, dhe me kushtin që këto të zhvillohen në përputhje me Seksionin 4 të PPRr-së. Krahas mbledhjeve përkatëse të korporatës në të cilat merr pjesë OPRr-ja, për sa i përket miratimit paraprak të OPRr-së lidhur me bërjen publike të INT-së (kur arsyetohet), ju lutemi shihni seksionin 3.3.1 më poshtë.

3.3 Dhënia e rekomandimeve dhe e asistencës/këshillave

Për sa i përket ndarjes së kompetencave ndërmjet Bordit dhe Drejtorit Menaxhues, të mbështetur nga anëtarët të tjerë të EL-së (seksioni 3.1.1.2 i PPRr-së) dhe monitorimi i detyrimeve të TAP-it (seksioni 3.1.1.3 i

¹ Ndryshimet më të fundit në PPRr u miratuan nga Autoritetet nëpërmjet vendimeve kombëtare të mëposhtme: Rezoluta e ARERA-s 334/2020/R/GAS e datës 15/09/2020 në lidhje me miratimin e programit të pajtueshmërisë të përgatitur nga TAP AG në përputhje me vendimin përfundimtar për ta certifikuar TAP AG si një operator të pavarur të sistemit të transmetimit të gazit natyror, Vendimi i RAE-s Nr. 1331/2020 në lidhje me miratimin e Programit të rishikuar të Pajtueshmërisë së TAP AG për fazën e operimit të gazsjellësit TAP dhe Vendimi i ERE-s Nr. 149/2020 për miratimin e programit të pajtueshmërisë rregullatore të dorëzuar nga TAP AG në përputhje me Opinionin e Përbashkët Përfundimtar në kuadër të procedurës së përjashtimit të gazsjellësit TAP.



Trans Adriatic
Pipeline

²I disponueshëm këtu.

PPRr-së), OPRr-ja krijoi një panoramë të qartë të aktiviteteve të TAP-it duke u përfshirë në mbledhjet përkatëse të korporatës dhe duke ofruar vazhdimisht këshilla lidhur me pajtueshmërinë rregullatore për përgatitjen e dokumentacionit për këto mbledhje korporate. Gjatë periudhës së raportimit, nuk u konstatua asnjë kundërvajtje ose shkelje.

3.3.1 Mosbërja publike/moskomunikimi i Informacionit me Ndjeshmëri Tregtare dhe i këshillave rregullatore të OPST-së

Si rregull i përgjithshëm, Punonjësit, si dhe anëtarët e Bordit dhe Zëvendësit nuk duhet të ndajnë ose t'u komunikojnë Aksionarëve, përfaqësuesve të Aksionarëve dhe Palëve të Treta Informacion me Ndjeshmëri Tregtare. PPRr-ja paraqet një listë shteruese të shembujve të asaj që mund të përbëjë INT. Kur duhet të ndahen Informacione me Ndjeshmëri Tregtare, me një Aksionar të veçantë, përfaqësues të Aksionarëve ose Palë të Tretë për një qëllim thelbësor për operimin e suksesshëm të Gazsjellësit TAP, në veçanti lidhur me financimin e projektit, këto informacione u nënshtrohen disa kushteve dhe një procesi të caktuar, sikurse detajohet në seksionin 4 të PPRr-së.

Vlen të theksohet se OPRr-ja është konsultuar rregullisht lidhur me parandalimin e bërjes publike të INT-së (sikurse parashikohet në seksionin 4 të PPRr-së dhe në Nenin 16 të DG-së) dhe OPRr-ja arriti në përfundimin se aktivitetet dhe dokumentet e vlerësuara ishin në përputhje me PPRr-në. Më konkretisht, OPRr-ja dha rekomandime për pajtueshmërinë rregullatore të OPST-së:

- lidhur me kualifikimin e informacionit si INT në përgatitjen e dokumentacionit për Bordin, Komitetet Këshillimore të Bordit, grupet e punës, audituesit;
- për qëllime qeverisjeje;
- kontratat (nga pikëpamja e INT-së dhe e kërkesave të tjera të OPST-së);
- politikat e TAP-it; dhe
- këshilla të tjera për pajtueshmërinë rregullatore për një larmi çështjesh.

3.4 Shkeljet e mundshme

OPRr-ja ua komunikon shkeljet e mundshme të PPRr-së Autoriteteve. Drejtori Menaxhues dhe/ose Bordi i TAP-it, sipas nevojës, duhet të informohen në kohë për këto shkelje të mundshme të PPRr-së (seksioni 3.1.1.1(d) i PPRr-së). Gjithashtu, OPRr-ja ka të drejtën t'ua njoftojë shkeljet thelbësore lidhur me zbatimin e PPRr-së Autoriteteve (seksioni 3.1.1.1(h) i PPRr-së).

Gjatë periudhës së raportimit, nuk u konstatuan incidente lidhur me pajtueshmërinë rregullatore.

3.5 Raportet për Autoritetet dhe Bordin

Në bazë të DG-së, OPRr-ja raporton rregullisht, qoftë verbalisht apo me shkrim, pranë Autoriteteve dhe ka të drejtën t'i raportojë, verbalisht ose me shkrim, Bordit Mbikëqyrës.

Për ndërveprimin e OPRr-së me Autoritetet në lidhje me ndryshimet anëtarësisë së Bordit gjatë kësaj periudhe raportimi, ju lutemi shihni seksionin 3.7.2 të raportit aktual.

OPRr-ja ka mundësinë të ngrejë problematika me Bordin duke marrë në konsideratë linjën e raportimit të drejtpërdrejtë me Kryetaren e Bordit dhe pjesëmarrjen e saj në mbledhjet e Bordit.

3.6 Pavarësia operationale

Në vitin 2022 nuk pati ankesa të ngritura nga transportuesit (e mundshëm).

Për sa i përket detyrimit të TAP-it për t'u pajisur me të gjitha burimet njerëzore, teknike dhe fizike të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve dhe detyrave të tij, si një OPST plotësisht i pavarur dhe i certifikuar, në përputhje me DG-në, për ruajtjen e subjektit të veçantë të korporatës nga Aksionarët, marrëveshjet e mundshme me Aksionarët e filialeve dhe parimet lidhur me të komanduarit, për periudhën e raportimit nuk ka zhvillime lidhur me këtë që mund të përmenden.

3.7 Pavarësia organizative

3.7.1 Kërkesat për pavarësinë

Lidhur me *pavarësinë e anëtarëve të Bordit dhe zëvendësve të tyre*, në përputhje me seksionin 3.3.1 të PPRr-së, OPRr-ja monitoron përbërjen e Bordit dhe zbatimin efektiv të detyrave të tij në përputhje me DG-në. Të paktën gjysma e anëtarëve të Bordit, minus 1, si dhe zëvendësit e tyre, duhet të përmbushin kërkesat për pavarësinë të Direktivës së Gazit dhe të nënshkruajnë Deklaratën e Pavarësisë.³

Në vitin 2022, OPRr-ja u komunikoi Autoriteteve pesë sete ndryshimesh të anëtarësisë së Bordit (ju lutemi, shihni seksionin 3.7.2 më poshtë). Është respektuar pragu i gjysmës së anëtarëve të Bordit, minus 1, që duhet të përmbushin kërkesat për pavarësinë.

Në lidhje me **pavarësinë e punonjësve të TAP-it**, të gjithë punonjësit duhet të jenë të pavarur kur kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme dhe vendimmarrjen në TAP. Ata nuk duhet të udhëzohen nga TAP-i kur marrin vendime ose ushtrojnë detyrat e tyre në emër të TAP-it. Për periudhën e raportimit, të gjithë punonjësit e TAP-it kanë nënshkruar dispozitat përkatëse të pavarësisë, si pjesë të kontratës së tyre të punës me TAP-in (për më shumë detaje lidhur me shkallën e këtyre kërkesave për pavarësi, ju lutemi shihni seksionin 3.3.2 të PPRr-së.

Drejtori Menaxhues, anëtarët e tjerë të EL-së dhe OPRr-ja duhet të përmbushin Periudhat e Pritjes para dhe pas ngjarjes. Në veçanti, Periudha e Pritjes gjashtë muaj para ngjarjes zbatohet për të gjithë anëtarët e EL-së (përveç Drejtorit Menaxhues) për aq kohë sa shumica e anëtarëve të EL-së përmbushin Periudhën e Pritjes prej 3 vitesh pas ngjarjes.

3.7.2 Emërimi, rinovimi dhe përfundimi i mandatit të Bordit të TAP-it, Drejtorit Menaxhues dhe anëtarëve të tjerë të Ekipit të Lidershipit

Gjatë vitit 2022, OPRr-ja u komunikoi Autoriteteve pesë sete ndryshimesh në anëtarësinë e Bordit. Duke marrë parasysh kohëzgjatjen prej tre (3) javësh të parashikuar në DG dhe PPRr për Autoritetet që ta shqyrtojnë këtë njoftim, si dhe referencën për miratimin e nënkuptuar të Autoriteteve për çështjen në Shtojcën 1 të PPRr-së së TAP-it, TAP-i përmendi se në rast se Autoritetet nuk kishin vërejtje në lidhje me deklaratat e paraqitura në këtë njoftim gjatë periudhës tremujore, TAP-i do të supozonte se Autoritetet i kishin miratuar në heshtje ndryshimet e sipërpërmendura në anëtarësinë e Bordit. AKRr-të nuk parashtruan asnjë koment dhe pyetje në lidhje me këto njoftime.

3.8 Trajnimet dhe komunikimi

Dokumentacioni me shkrim dhe këshillat e izoluara nuk garantojnë efektivitetin e programit të pajtueshmërisë rregullatore, por ato janë thjesht pikënisja.

Për rrjedhojë, u zhvilluan trajnime gjithëpërfshirëse dhe ballë për ballë (kryesisht nëpërmjet videokonferencave) për PPRr-në. Në vitin 2022, OPRr-ja zhvilloi: (i) trajnime familjarizimi me PPRr-në për punonjësit e rinj të TAP-it, konsulentët, anëtarët e Bordit dhe zëvendësit, dhe (ii) trajnime të shënjestruara të PPRr-së (këtë herë, fokusi ishte te kërkesat e OPST-së të zbatueshme për kontratat). Gjithashtu, në nëntor 2022, OPRr-ja i prezantoi të gjithë punonjësit e TAP-it me një trajnim rifreskues të PPRr-së, duke përfshirë një kuiz. Në tërësi, në vitin 2022, **221 individë** u trajnuan për PPRr-në, sikurse detajohet në grafikun më poshtë. Ky numër nuk përfshin trajnimin e zhvilluar lidhur me linjën e re të integritetit në janar 2022. Për sa i përket të fundit, u trajnuan **127 individë**.

³ Pasi kjo ishte miratuar nga Autoritetet.




Figura 1 – Pamje e trajnimeve për PPRr-në në vitin 2022

Në vitin 2022, **101 individë** nënshkruan **Deklaratën e angazhimit për PPRr-në**. Grafiku më poshtë pasqyron një segmentim të këtij numri të përgjithshëm sipas kategorive të caktuara, sikurse janë parashikuar në PPRr.

Për më tepër, katër individë nënshkruan Deklaratën e Pavarësisë të zbatueshme për anëtarët e Bordit dhe Zëvendësit e emëruar nga aksionarët e OPST-së së TAP-it.



Figura 2 – Pamje e Deklaratave të nënshkruara të angazhimit për PPRr-në në vitin 2022

Komunikimi është një tjetër element kyç për zbatimin efektiv të PPRr-së. Kjo fushë është e veçantë nga trajnimi dhe përfshin përpjekje për t'i mbajtur punonjësit të informuar për zhvillimet madhore lidhur me pajtueshmërinë rregullatore dhe për ta pasur pajtueshmërinë si pararojë të vetëdijes së punonjësve.

Titulli i Dokumentit:	Raporti i Pajtueshmërisë Rregullatore për vitin 2022	
Nr. i Dokumentit:	CAL00-TAP-RCO-X-TRF-0006	Rish. 0

Në vitin 2022, (i) kuizi dhe trajnimi rifreskues për PPRr-në, dhe (ii) një kuiz për çështjet ligjore dhe të pajtueshmërisë (duke përfshirë pyetje lidhur me pajtueshmërinë rregullatore të OPST-së) u komunikuan nëpërmjet një emaili që qarkulloi te gjithë stafi i TAP-it dhe postimeve të lajmeve të brendshme në intranetin e TAP-it (ju lutemi, shihni figurën 3 më poshtë).




Figura 3 – Komunikimi i Pajtueshmërisë Rregullatore



Titulli i Dokumentit:	Raporti i Pajtueshmërisë Rregullatore për vitin 2022	
Nr. i Dokumentit:	CAL00-TAP-RCO-X-TRF-0006	Rish. 0
Klasifikimi:	PUBLIK	

4. Dokumentacioni

Të dhënat	Kodi/Numri i dokumentit	Gjeneruar nga	Përgj. për Ruajtjen	Mënyra e Ruajtjes	Vendndodhja	Periudha e ruajtjes para depozitimit
Nuk ka						

Titulli i Dokumentit:	Raporti i Pajtueshmërisë Rregullatore për vitin 2022	
Nr. i Dokumentit:	CAL00-TAP-RCO-X-TRF-0006	Rish. 0
Klasifikimi:	PUBLIK	

5. Lista e Shtojcave

Nuk ka për këtë raport.